



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I BASHKISË FIER

Nr. 13325 Prot

Fier më 26.12.2024

VENDIM

Nr. 139 Datë 23. 12. 2024

“Për miratimin e Programit Buxhetor Afatmesëm (PBA) 2025-2027 përfundimtar, dhe miratimin e Buxhetit të Vitit 2025, për Bashkinë Fier

Këshilli Bashkiak Fier në mbledhjen e tij të datës 23.12.2024, me propozim të Kryetarit të Bashkisë, mbështetur në nenin 9 pika 1.3 shkronja “c”, 34, 40,41, 54 shkronja “dh” të ligjit nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore“ i ndryshuar ; kreu III, nenet 10-20, kreu IV, nenet 22-29, kreu VII, nenet 39-41 të ligjit nr. 68/2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”, i ndryshuar ; ligjit nr. 9936, datë 26.06.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë” të ndryshuar, ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” të ndryshuar; Udhëzimit të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr. 23 datë 30.07.2018 “Për procedurat standarte të përgatitjes së programit buxhetor afatmesem të NJQV”, Udhëzim plotësues nr. 03 datë 28.02.2024 “Për përgatitjen e programit buxhetor afatmesëm vendor 2025-2027” me shtojcat plotesuese; Udhëzimit të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr. 08 datë 05.07.2024 “Për përgatitjen e Programit Buxhetor Afatmesëm Vendor 2025-2027”; Udhëzimit të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr. 9 datë 20.03.2018 “Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit”, i ndryshuar; Shkreses së Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr. 14088 date 28.10.2024 “ Dergohet per njoftim Transfera e Pakushtezuar e Pergjithshme per vitin 2025 “ dhe relacionit të administratës së Bashkisë Fier. Për sa më sipër, Këshilli i Bashkisë Fier,

VENDOSI:

1. Të miratojë programin buxhetor afatmesem përfundimtar për vitet 2025 - 2027, dhe buxhetin e vitit 2025 të Bashkisë se Fier , si më poshtë:
 - a) Të miratojë tavanet për çdo program, për vitin 2025 - 2027 të programit buxhetor afatmesëm sipas tabelës PBA1 dhe programeve buxhetore të detajuara , pjesë përbërëse e këtij projekt-vendimi.
 - b) Të miratojë të ardhurat sipas përputhshmërisë me rregullat fiskale në fuqi dhe shpenzimet e buxhetit, sipas zërave kryesorë, për dy vitet e mëparshme buxhetore dhe tre vitet e ardhshme, sipas tabelës PBA2 , pjesë përbërëse e këtij projekt-vendimi.

- c) Të miratojë detajimin e shpenzimeve të programit sipas klasifikimit ekonomik, shpenzimet sipas klasifikimit funksional dhe shpenzimet sipa programit dhe klasifikimit funksional për vitet 2025-2027 sipas tabelës PBA3, 4 dhe 5 pjesë përbërëse e këtij projekt vendimi.
- d) Të miratojë qellimet ,objektivat, deklaratën e politikës si dhe shpenzimet për çdo produkt për çdo program, për vitin 2025 - 2027 të programit buxhetor afatmesëm sipas tabelës PBA6,7 dhe programeve buxhetore të detajuara, informacionin baze të NJQV , tabeja PBA 9, pjesë përbërëse e këtij vendimi.
- e) Të miratojë listën e projekteve të investimeve publike, për çdo program, sipas tabelës PBA8, pjesë përbërëse e këtij vendimi.
- f) Të miratojë fondet buxhetore, të parashikuara sipas programeve buxhetore për çdo njësi shpenzuese, për vitet 2025-2027 , të ndara në korrente dhe kapitale; sipas tabelës BV1 , pjesë përbërëse e këtij vendimi.
- g) Të miratojë numrin e punonjësve të Bashkisë Fier dhe institucioneve në varësi për vitin 2025, sipas tabelës BV5, pjesë përbërëse e këtij vendimi
- h) Të miratojë shpenzimet të Bashkisë sipas Klasifikimeve Buxhetore sipas tabelës BV6, pjesë përbërëse e këtij vendimi
- i) Të miratojë listën e projekteve të investimeve publike, për çdo program, dhe sipas burimit sipas tabelës BV7, pjesë përbërëse e këtij vendimi

2. Tabelat shoqeruese:

- a) Lista e njësive shpenzuese të bashkisë Fier , sipas tabelës BV -9 pjesë përbërëse e këtij vendimi.
- b) Një përmbledhje të pagesave të vonuara ndaj palëve të treta, përfshirë edhe origjinën e tyre dhe masat për likuidimin e parandalimin e krijimit të tyre, sipas tabelës BV, 11 pjesë përbërëse e këtij vendimi.
- c) Projektin e parë të planit të arkës të të ardhurave të veta të vitit 2025 dhe PBA 2025-2027 , sipas tabelës nr. BV-15 pjesë përbërëse e këtij vendimi

3. Eshhtë kompetencë e Kryetarit të Bashkisë:

- a) Rishpërndarja e projekteve të investimeve, brenda të njëjtit program;
- b) Rishpërndarja ndërmjet zërave të shpenzimeve korrente, brenda të njëjtit program;
- c) Rishpërndarja brenda të njëjtit program dhe zërit të shpenzimeve korrente, ndërmjet njësive të ndryshme shpenzuese.

4. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Drejtoria e Financës Buxhetit dhe Kontabilitetit dhe Drejtuesit e institucioneve në varësi të Bashkisë Fier

5. Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë pas shpalljes.

KRYETAR I KËSHILLIT
ANTONETA ÇUNAJ

